

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"LI - VE 2022" sh.p.k**

Në Tiranë, sot më date 12/01/2022.

Z.Endrit Paparisto, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, me 10/06/1987 banues në adresën Rruga Naim Frasheri, pallati 60/2, ap.4, Tirane, mbajtës i kartës së indentitetit me nr. 170610068F

Z.Alban Velo, shtetase shqiptare, lindur në Lushnje, me 16/05/1976 dhe banuese në adresën Him Kolli, P 33, AP7/31 Tirane, mbajtes i kartes se indentitetit me nr. H60516140E,

Në cilësinë e "ortakeve themelues" kanë rënë dakort, për hartimin e këtij akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojnë se me vullnet të lire, të plote e të sigurtë, dhe iniciativë të lire private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, "LI – VE 2022" sh.p.k.

**KREU I**

**Neni 1**

**Kriimi**

Shoqëria "LI – VE 2022" sh.p.k. është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar pranë QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "LI - VE 2022" sh.p.k. është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortakët e cila nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nenshkuara.. Kontributi i ortakut të vetëm përben kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortakët gezojnë kuotën e tyre në shoqëri në përpjestim me kuotën që ka dhënë në kapital.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria e ka selinë në Rruga Besim Imami, Pallati 2/1, Kati I 3, Apartamenti nr 2, Njesia bashkiake nr 7, Tirane. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nëpërmjet vendimit të vetëm



nga administratoret si edhe te hape zyra perfaqësie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim te asamblesë se përgjithshme.

#### **Neni 4**

##### **Objekti i veprimtarisë**

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike solare (fotovoltaike) dhe energjise se eres (eolike) ne Republiken e Shqiperise dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Ministrive e Institucioneve te Shtetit Shqiptar i te gjitha miratimeve, lejeve dhe licensave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise. Shoqeria ka te drejte te ushtroje cdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente te fushes. Per qellime investimesh ne sektorin bujqesor/agrar/blegtori, ndertim me qellim komercial tregtar, residencial, etj, Dhenie me qera/nenqera pronash/ asete , menaxhim pronash, shitblerje real estate, Konsulence financiare, cdo lloj aktiviteti tjeter qe lejohet sipas legjislacionit shqiptar.

#### **Neni 5**

##### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj juridik dhe fiskal në (QKR) Regjistrin Tregtar, dhe do të vazhdojë per një periudhë kohore te papercaktuar.

#### **Kreu I I**

##### **Kapitali**

#### **Neni 6**



##### **Kapitali Themeltar**

Kapitali i shoqërisë është 100000(njeqind mije) Lekë. Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga 2 kuota me vlerë, si me poshte:

Z. Endri Papanisto, zoterues i l(nje) kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise me vleren 50000(pesedhjete mije) lek.

Z. Alban Velo , zoterues e I (nje) kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit të shoqëEise me vleren 50000(pesedhjete mije)lek ,

*Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqesohen nga letra me vlerë të trashegueshme. Kontributi I ortakut mund të jetë në para ose në natyre( pasuri e luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërise kundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërise.*



## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Orkaket kanë të drejte tju trashgojnë kuotat e tyre bashkeshortes/bashkeshortit dhe femijeve.
- f) Në rast se ndonjeri nga ortakët dëshiron të shes kuotat perkatëse, duhet tu japi prioritet fillimisht ortakëve të tjerë nëse ata janë të interesuar në blerjen e tyre, nëse asnjë nga ortakët nuk shfaq interes ai ka të drejtë të shesë kuotat e veta paleve të treta të interesuara

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, duhet të perpilohet dhe firmoset kontratë me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zoterimi i kuotave, deri në castin e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## Kreu III

### ORGANET VENDIMEMARRESE DHE DREJTUESE

## Neni 8

### Organi Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm në rast se shoqëria është e themeluar nga një ortak i vetëm. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratorëve;
- g) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "G" të kësaj pike;



- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- l) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- l) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; investime; vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. të bleje, shese, kembeje pasuri të patundshme të shoqërisë, për shpërndarjen e fitimit

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmerinë, apo në bazë të rrethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

## **Neni 9** **Administrimi**

Administrator i shoqërisë është Znj. Sidorela Karapici mbajtëse e kartës së identitetit me nr.J55306059J emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar. Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Administrator I shoqërisë është Z. Alban Velo mbajtës I kartës së identitetit me nr H60516140E emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar. Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## **Neni 10** **Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:



- a) te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) perfaqësoje shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt të dokumenteve;
- q) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet per shpërndarjen e fitimeve, paraqesin keto dokumente perpara asamblesë së përgjithshme per miratim;
- d) krijoje nje sistem paralajmërimi në kohën e duhur per rrethanat, që kercenojne mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- dh) te kryeje regjistrimet dhe dërgojne te dhënat e detyrueshme te shoqërisë, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombëtare të Regjistrimit;
- e) te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit.
- h) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;
- g) te raportoje përpara asamblese se pergjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaqme me rendësi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare
- h) te bleje dhe te shese, ne emer te shoqerise, prona dhe pasuri te palujteshme si brenda territorit te Shqiperise ashtu dhe jashte territorit te saj;

Administratori eshte i detyruar te therrasi mbledhjen e asamblese së pergjitheshme dhe ne rastet kur:

sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te blejë nga nje ortak pasuri, që kane vlere më të lartë se 5 per qind te asetëve te shoqërisë, rezulton ne pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshëm e te jashtëzakonshëm. Administratori perfaqeson Shoqërinë përpëra te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo te huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore te gjitha shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per të vepruar ne marrëdhënie me te tretet ne emer te shoqerise, në te gjitha rrethanat me përjashtim te kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me te tretët nepërmjet akteve qe jane ne përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsiper pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se te tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur te tretët nuk mund ta injoronin këtë akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

**Neni 11**  
**Viti Financiar**

*Propozita*

*Albon Veli*

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Me perjashtim te vitit te pare financiar qe fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## **Neni 12**

### **Shpërndarja ose prishja e shoqerisë**

**Shpërndarja ose prishja e shoqerisë mund te bëhet në cdo kohë :**

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim te ortakeve te shoqerise;
  - c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
  - q) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit";
  - a) d) me vendim të gjykatës;
- Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit te shoqerisë, duke caktuar I apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqeri në likuidim e sipër ".

## **Neni 13**

### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 14**

### **Dispozita përfundimtare**

Ky Statut u redaktua ne 3 kopje me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe, dhe pasi iu lexua ortakeve themeltar të shoqërisë, nënshkruhet me vullnetin e lirë prej tyre.

## **ORTAKU I SHOQERISE**

**ENDRIT PAPANISTO**

*Endrit Papanisto*  
*E Papanisto*

**ALBAN VELO**

*Alban Vello*  
*Alban Vello*